

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6466
E mërkurë, 17 nëntor 2021
çmimi 0.40

Refuzohet ankesa e Thaçit për legjitimitetin e Speciales I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA EMËRUAR MINISTRIN E RI TË SHËNDETËSISË I FAQE 4-5

RIFAT LATIFI EMËROHET MINISTËR I SHËNDETËSISË



Mjeku shqiptaro-amerikan, Rifat Latifi, është emëruar të martën ministër i Shëndetësisë. Ai ka deklaruar se do të angazhohet për t'i ngrehur standardet e shërbimeve shëndetësore. Gjithashtu, Latifi është zotuar se do të punojë që ta ndalë largimin e mjekëve nga Kosova dhe largimin e pacientëve për t'u shëruar jashtë vendit. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se përvoja e madhe e Latifit do ta ndihmojë shumë shëndetësinë e Kosovës

FLET PËR "EPOKËN E RE", BASHKIM HADËRGJONAJ I FAQE 3

SË SHPEJTI HAPET SHKOLLA SHQIPE "LIRIA" NË NORVEGJI

Kryetari i Shoqatës "Liria" në Kristiansand të Norvegjisë, Bashkim Hadërgjonaj, ka thënë se shqiptarët në këtë qytet janë mjaft të organizuar. Hadërgjonaj në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se shoqata që drejton ka dhënë kontribut të çmuar para dhe pas çlirimit të Kosovës. Duke folur për rolin e kësaj shoqate, Hadërgjonaj ka bërë me dije se në fund të këtij viti ose në fillim të vitit 2022 do të hapet shkolla shqipe në Kristiansand

- Më shumë se tri dekada histori shqiptare në Kristiansand të Norvegjisë



AKTUALE



PRESIDENTJA OSMANI: QYTETARËT E KOSOVËS U BESOJNË GRAVE F. 7

KËRKOHEM TË HETOHEN VOTAT E ARDHURA NGA DIASPORA F. 6

TË ENJTEN KUVENDI MBAN SEANCË, OPOZITA KRITIKON MAZHORANCËN F. 7

VËZHguesit e BE-SË VLERËSOJNË POZITIVISHT RAUNDIN E DYTË TË ZGJEDHJEVE F. 6

EKONOMI



MOSPAGESA E RRYMËS NË VERI, KURTI: FAJIN E KANË STRUKTURAT PARALELE F. 8

KRYETARIT TË PRISHTINËS NUK DO T'I MJAFTOJË BUXHETI F. 8

"KOSOVA VËSHITËRË SE DO T'I PËRMBUSHË OBJEKTIVAT E AGJENDËS SË GJELBËR" F. 8

SPORT

ASTERA DHE DEA TRANSFEROHEN NË SHBA F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhep isht
Tetov*
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 0
+389 44 487 795
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
ND, RTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov*,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinkeni i shkruan letër ministres Xhaçka: Besimplotë në vazhdimin e partneritetit strategjik

TIRANË, 16 NËNTOR - Sekretari amerikan i shtetit, Antony J. Blinken, nëpërmjet një letre dërguar ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Olta Xhaçka, ka shprehur mirënjohjen për kontributin e dhënë nga Shqipëria në strehimin e qytetarëve afganë gjatë dy muajve të fundit. "Në emër të Departamentit të Shtetit, dëshiroj t'i shpreh mirënjohjen tonë më të thellë Republikës së Shqipërisë që ishte vendi i parë që ofroi një parajsë të sigurt për afganët e rrezikuar dhe për zemërgjerësinë e kurajon që populli juaj ka treguar gjatë gjithë operacioneve të NATO-

s në Afganistan. Në mënyrë të veçantë dëshiroj t'ju përgëzoj për ndërhyrjen e fuqishme në ministerialin e datës 20 gusht të takimit virtual të ministrave të jashtëm", ka nënvizuar Blinkeni në letrën e tij. Sekretari amerikan është shprehur se me anë të këtyre veprimeve Shqipëria ka treguar edhe një herë përkushtimin e saj të fortë ndaj aleancës së NATO-s, ndërsa ka vlerësuar kontributin e Shqipërisë në të gjitha operacionet e NATO-s në Afganistan gjatë të cilave u angazhuan rreth 4 000 trupa të forcave të armatosura. "Investimi i Shqipërisë për

sigurinë dhe prosperitetin e popullit afgan ka ndihmuar shumë për avancimin e synimeve tona të përbashkëta. Trupat shqiptare ndihmuar për krijimin e një ambienti të qëndrueshëm dhe të sigurt për forcat tona si dhe për popullin afgan. Prania e tyre ka bërë të mundur që Aleanca e NATO-s të kryejë operacionet e saj, t'u mundësojë vazhdimin e reja ndjekjen e shkollës si dhe kanë bërë më të sigurt jetën e përditshme për shumë qytetarë afganë. Shtetet e Bashkuara vlerësojnë thellë marrëdhënien tonë të ngushtë me Shqipërinë dhe mbetemi besimplotë për



vazhdimin e këtij partneriteti strategjik për avancimin e interesave tona të përbashkëta", ka shkruar Antony Blinken në letrën që ia ka dërguar homologes nga

Shqipëria. Letra e sekretarit Blinken i është dorëzuar ministres Xhaçka nga ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Yuri Kim.

Përleshje të reja ndërmjet forcave polake dhe emigrantëve

VARSHAVË, 16 NËNTOR - Emigrantët e bllokuar në Bjellorusi janë përleshur me ushtarët polakë në kufirin mes dy vendeve. Ata kanë hedhur gurë dhe gjësende të forta në rojet e armatosura rëndë, të cilët u kundërpërgjigjën me topa uji dhe gaz lotsjellës. "Emigrantët po përpiqen ta shkatërrojnë gardhin dhe të shkojnë në Poloni. Shërbimet tona përdorën gaz lotsjellës për t'i zbrapsur ata", ka shkruar Ministria e Mbrojtjes e Polonisë

më 16 nëntor në rrjetin social "Twitter". Ministria ka publikuar një video e cila shfaqte dhunën që ka ndodhur në pikën kufitare të Kuznicës.

Situata në kufirin mes Polonisë, e cila është vend anëtar i Bashkimit Evropian dhe Bjellorusisë, është përkeqësuar ditët e fundit. Mijëra njerëz, kryesisht nga Lindja e Mesme, janë të ngecur në kampe të improvizuara në kushte të vështira në anën bjelloruse të kufirit me Poloninë, Letoninë



dhe Lituaninë. BE-ja po e akuzon udhëheqësin autoritar bjellor, Alyksandr Lukashenka, se po dërgon në mënyrë të organizuar emigrantë në kufijtë e BE-së. Kjo, sipas BE-

së, po ndodh si shenjë hakmarrjeje kundër sanksioneve të vendosura pas zgjedhjeve presidenciale në gusht 2020, kur Lukashenka shpalli fitoren, pavarësisht prej akuzave nga opozita dhe Perëndimi se zgjedhjet ishin të manipuluar. Pas zgjedhjeve, Bjellorusia është përfshirë nga protestat e opozitës të cilat janë goditur me forcë nga regjimi i Lukashenkas. Shumica e liderëve të opozitës janë larguar nga vendi për ta shmangur arrestimin.

Qeveria e Lukashenkës, e cila mbështetet nga Rusia, ka mohuar akuzat e BE-së se po i përdor emigrantët si mjet shantazhi dhe akuzon bllokun për shkelje të të drejtave të njeriut duke i refuzuar të aplikojnë për azil. Më 15 nëntor Bashkimi Evropian ka njoftuar për sanksione të reja ndaj Bjellorusisë, ndërkohë administrata e presidentit amerikan, Joe Biden, ka thënë se është duke përgatitur sanksione të reja.

Gjermania pezullon certifikimin e gazsjellësit rus

BERLIN, 16 NËNTOR (ER) - Rregullatori federal gjerman i energjisë ka bërë me dije se ka ndaluar përkohësisht procesin e miratimit të gazsjellësit rus "Rrjedha Veriore 2". Përmes këtij gazsjellësi Rusia synon ta furnizojë Gjermaninë me gaz natyror.

Agjencia Federale e Rrjetit (Bundesnetzagentur) ka njoftuar më 16 nëntor se ka pezulluar procedurën e certifikimit për gazsjellësin, punimet e të cilit kanë përfunduar gjatë periudhës



së fundit. Rregullatori gjerman ka arritur në përfundimin se "do të ishte e

mundur të certifikohet një operator i gazsjellësit 'Rrjedha Veriore 2' vetëm nëse ai është i

organizuar sipas ligjit gjerman". Sipas agjencisë, një degë e krijuar për ta administruar pjesën gjermane të gazsjellësit nuk i plotësonte kushtet për të qenë një "operator i pavarur transmetimi". Vendimi i rregullatorit ndodh pasi Evropa po përballet me rritjen e çmimit të energjisë. Një të tretën e furnizimeve me gaz Evropa e ka nga Rusia. Tubacioni rus do t'i dyfishojë furnizimet me gaz rus në Gjermani.

Autoritetet gjermane kanë thënë se tubacioni është i nevojshëm për ta ndihmuar vendin ta shmangë qymyrin dhe energjinë bërthamore. Gjermania është ekonomia më e madhe evropiane. Por, kritikët thonë se gazsjellësi do ta rrisë varësinë energjetike të BE-së nga Rusia, ndërkohë që do t'i mundësojë Moskës ta shmangë Ukrainën, duke i pamundësuar këtij vendi të përfitojë miliarda dollarë në vit tarifa tranziti.

Tentim për përleshje fizike mes deputetëve të Shqipërisë, ndërhyrje sigurimi

TIRANË, 16 NËNTOR - Një debat në distancë në mes të mes dy deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, Ervin Saliç dhe Erion Braçe, ka rrezikuar të përshkallëzohet në konflikt fizik ndërmjet të dyve. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, Saliç

e ka akuzuar ish-zëvendëskryeministrin Braçe se i del emri në përgjimet e prokurorisë italiane për çështjen e Rezart Taçit. "A je ti zëvendëskryeministri që del në përgjimet e prokurorisë italiane? Mos m'u drejto mua

si kone se je mësuar me këta", i ka thënë Saliç, deputetit socialist teksa ky i fundit replikonte nga vendi. Më pas të dy lanë vendet e tyre duke u drejtuar për te njëri-tjetri, por ishin punonjësit e gardës që shmangën përleshjen.



KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA EMËRUAR MINISTRIN E RI TË SHËNDETËSISË

Rifat Latifi emërohet ministër i Shëndetësisë

Mjeku shqiptaro-amerikan, Rifat Latifi, është emëruar të martën ministër i Shëndetësisë. Ai ka deklaruar se do të angazhohet për t'i ngritur standardet e shërbimeve shëndetësore. Gjithashtu, Latifi është zotuar se do të punojë që ta ndalë largimin e mjekëve nga Kosova dhe largimin e pacientëve për t'u shëruar jashtë vendit. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se përvoja e madhe e Latifit do ta ndihmojë shumë shëndetësinë e Kosovës

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të martën ka emëruar Rifat Latifin ministër i Shëndetësisë. Pas marrjes së detyrës, Latifi është zotuar se do të angazhohen për ngritjen e standardeve mjekësore, për edukimin, për trajnimin dhe për specializimin e punëtorëve shëndetësorë. "Faleminderit për nderin e madh që më keni bërë me këtë detyrë të jashtëzakonshme. Me ngritjen e kapaciteteve njerëzore ne do të investojmë për rritjen e kualitetit të shërbimeve. Shërbimet do të krijojnë të ardhura. Me të ardhurat e shërbimeve ne investojmë sërish në kualitet. Kur t'i ofrojmë shërbimet e ndryshme dhe ngritjen profesionale të të rinjve, mjekëve, infermierëve, do ta ndërpresim largimin e trurit shkencor dhe mjekësor në

vendet e rajonit e më gjerë", ka thënë Latifi në një konferencë për media së bashku me kryeministrin Kurti.

Ai ka thënë se do të angazhohet që ta ndalojë largimin e pacientëve për t'u shëruar jashtë vendit, duke ua mundësuar kushtet që trajtimin ta marrin në Kosovë. "Me ngritjen e kapaciteteve si pjesë e trupit tonë, do ta ndalojmë largimin e pacientëve nga vendi, këto investime që bëhen në vende të tjera, do t'i kthejmë në investim në shtëpinë tonë. Do të jetë e qartë se pastaj pacientët tanë do të jenë në shtëpinë tonë. Ky proces do të zgjasë, por ne do ta kemi strategjinë. Në këtë rrugëtim duhet të adaptohem për të rehat e mjekësisë dhe t'i njohim ato vetë. T'i udhëheqim me hulumtimet tona mjekësore dhe shkencore. Rezultatet nuk do të shihen brenda ditës", ka deklaruar ai.

I pyetur se si do t'i përgjigjet ndonjë vale të mundshme me



Haradinaj mirëpret emërimin e ministrit të ri të Shëndetësisë

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përshëndetur vendimin e kryeministrit Albin Kurti për të emëruar ministër të Shëndetësisë mjekun shqiptar nga ShBA-ja, Rifat Latifi. Në llogarinë e vet në "Facebook", Haradinaj ka shkruar se ministrit të ri i uron sukses në fuqizimin e shëndetësisë së Kosovës dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve. "Përshëndes emërimin e kirurgut të njohur dr. Rifat Latifi në detyrën e ministrit të Shëndetësisë. I uroj sukses në fuqizimin e shëndetësisë në Kosovë dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve", ka shkruar Haradinaj.

koronavirus, ministri Latifi ka deklaruar se sapo ka ardhur nga ShBA-ja dhe pret të takohet me ish-ministren e Shëndetësisë për

të marrë më shumë informacione. "Por, virusi është aktual. Do të jetë aktual dhe ne duhet të jemi të përgatitur për

këtë", ka thënë Latifi.

Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se përvoja e madhe e Latifit do ta ndihmojë shumë shëndetësinë e vendit tonë. "Përvoja e tij akademike dhe profesionale përfshinë qendra spitalore dhe universitete me emër në disa shtete të ShBA-së. Për momentin ai punon profesor dhe drejtues i Departamentit të Kirurgjisë në Kolegjin e Mjekësisë së Nju-Jorkut. Latifi është i angazhuar edhe në telemedicinën ndërkombëtare. Ka punuar në vazhdimësi për promovimin e shëndetësisë së Kosovës. Për angazhimin e tij është nderuar më shumë çmime ndërkombëtare. Është autor dhe bashkautor i mbi 350 punimeve shkencore. Latifi është kryetar dhe themelues i Kolegjit të Kirurgëve të Kosovës", ka thënë ai. Latifi ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës, ndërkaq specializimet për kirurgji të përgjithshme dhe traumatologji dhe reanimacion i ka përfunduar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Më herët Latifi ka qenë edhe këshilltar i ish-kryeministrit Hashim Thaçi. Latifi vjen në këtë pozitë pas dorëheqjes së Arben Vitit në tetor të këtij viti. Deri më tani Ministria e Shëndetësisë ishte udhëhequr nga Dafina Gexha-Bunjaku. Vitia i ishte futur garës për kryetar të Prishtinës, por nuk ka marrë besimin e qytetarëve për ta udhëhequr Prishtinën.

Refuzohet ankesa e Thaçit për legjitimitetin e Speciales

HAGË, 16 NËNTOR - Mbrojtësit e ish-drejtuës politik të UÇK-së, Hashim Thaçi, kanë paraqitur ankesë kundër vendimit të gjyqtarit të Këshillave të Specializuara të Kosovës (KSK). Gjykatësi ka refuzuar kërkesat e mbrojtjes së Thaçit për pezullim të procedurës dhe refuzim të aktakuzës, me të cilën ata e kanë kundërshtuar legjitimitetin dhe ligjshmërinë e asaj gjykate, themelimin e saj, formën e aktakuzës dhe të tjera. Ata me ankesë kanë kërkuar nga Dhoma e Apelit e KSK-së që të vërtetojë



se Gjykatës Speciale i ka skaduar mandati si dhe se Thaçit i janë shkelur të drejtat "aq sa vazhdimi

i gjykimit kundër tij do të cenonte thelbësisht kuptimin e kësaj procedure".

Ndër të tjera, në ankesën e shkruar në 20 faqe, avokatët mbrojtës kanë deklaruar se Gjykata Speciale nuk i plotëson kushtet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sepse nuk është e pavarur dhe e paanshme. "Mbrojtja pretendon se Ligji për KGJK-në (i miratuar nga Kuvendi i Kosovës) krijoi atë që zbatohet në praktikë për një gjykatë të jashtëzakonshme dhe se KGJK nuk i plotëson garancitë e pavarësisë dhe paansisë, pasi që ligji nuk parashikon rregulla adekuate për përbërjen dhe

emërimin e anëtarëve të saj, kohëzgjatjen e shërbimit, arsyet e shkarkimit, refuzimit dhe shkarkimit të anëtarëve të saj", është thënë në parashtresën e mbrojtjes së Thaçit.

Arsyeja e dytë e ankesës ka të bëjë me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për të cilën ata pretendojnë se nuk ekziston sepse Thaçi dyshohet se ka qenë nën dyshime që nga 7 janari 2011 kur është publikuar raporti i raportuesit special të Këshillit të Evropës, Dick Marty.

Pesë raste të reja me Covid dhe 2 800 të vaksinuar

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), gjatë 24 orëve të fundit janë

paraqitur vetëm pesë raste të reja me Covid. Po ashtu, kjo ministri ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë dhënë 2 800 doza të vaksinës kundër Covidit. "Prej fillimit të vaksinimit në

të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 597 345 doza të vaksinës. Deri më sot 751 131 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 1 474 testime, pesë qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin

Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar 22 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 570. Në total numri i rasteve aktive



është 407", ka njoftuar MSh-ja.



FLET PËR "EPOKËN E RE", BASHKIM HADËRGJONAJ

Së shpejti hapet shkolla shqipe "Liria" në Norvegji

- Më shumë se tri dekada histori shqiptare në Kristiansand të Norvegjisë

Kryetari i Shoqatës "Liria" në Kristiansand të Norvegjisë, Bashkim Hadërgjonaj, ka thënë se shqiptarët në këtë qytet janë mjaft të organizuar. Hadërgjonaj në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se shoqata që drejton ka dhënë një kontribut të çmuar para dhe pas çlirimit të Kosovës. Duke folur për rolin e kësaj shoqate, Hadërgjonaj ka bërë me dije se në fund të këtij viti ose në fillim të vitit 2022 do të hapet shkolla shqipe në Kristiansand

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

KRISTIANсанд, 19 NËNTOR - Kryetari i Shoqatës "Liria" në Kristiansand të Norvegjisë, Bashkim Hadërgjonaj, ka folur për rolin e shqiptarëve në këtë shtet për më shumë se tri dekada. Ai ka treguar se shoqata të cilën e drejton është themeluar në vitin 1987 në krye me Shefqet Pepën. Ai ka thënë se edhe si anëtar i kësaj shoqate ka kontribuar në çështjet kombëtare si para dhe pas çlirimit të Kosovës. "Kanë kaluar plot 34 vjet nga koha kur është iniciuar formimi i Shoqatës Kulturore Shqiptare 'Liria' në Kristiansand. Janë më shumë se tri dekada histori shqiptare në Kristiansand. Më fjalë të tjera,

shoqata jonë është krijuar në vitin e largët - 1987. Si shumë shoqata të tjera mërgimtarësh anekënd globit, edhe kjo shoqatë është krijuar për të dhënë një ndihmë në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave tona të shkëlqyera dhe për të zhvilluar një veprimtari të organizuar si komunitet shqiptar. Shoqata jonë është krijuar edhe për të qenë një zë i fortë i trojeve tona (shumë prej tyre) atëherë të robëruar. Ishte grupi iniciues në krye Shefqet Pepën që i dhanë shoqatës sonë emrin 'Liria' në vitin e largët 1987", ka thënë Hadërgjonaj.

Hadërgjonaj në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re" ka bërë me dije se shumë shpejt do të fillojë shkolla shqipe në Kristiansand e cila do të quhet "Liria". Në këtë kontekst, ai ka thënë se ka mbetur

sfiduese pajisja me tekste shqipe si dhe pagesa e mësimdhënësve. Sa iu përket teksteve në gjuhën shqipe, Hadërgjonaj ka thënë se janë duke bërë përpjekje që të sigurojnë tekste shkollore në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Oslo dhe shoqatat e tjera shqiptare këtu në Norvegji. "Besojmë se shumë shpejt, në dhjetor 2021 ose janar 2022, do të fillojmë me mësimin plotësues në gjuhën shqipe për fëmijët e klasave të ulëta. Shkolla shqipe do ta mbajë emrin 'Liria'. Kemi për momentin mungesë të teksteve/librave shkollore në gjuhën tonë. Po përpiqem të sigurojmë tekste/libra shkollore në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Oslo dhe shoqata të tjera shqiptare këtu në Norvegji. Kemi mungesë të mësuesve vullnetarë të ciklit të ulët. Ne si shoqatë kemi vështirësi të mëdha për të siguruar të ardhura për mësuesit", ka thënë ai.

Epoka e re: Z. Hadërgjonaj, ju jeni kryetar i Shoqatës "Liria" në Kristiansand. Na tregoni se sa anëtarë ka kjo shoqatë dhe kur është themeluar?

Hadërgjonaj: Kanë kaluar plot 34

vjet nga koha kur është iniciuar formimi i Shoqatës Kulturore Shqiptare "Liria" në Kristiansand. Janë më shumë se tri dekada histori shqiptare në Kristiansand. Më fjalë të tjera, shoqata jonë është krijuar në vitin e largët 1987, kur unë isha vetëm 11 vjeç. Unë kam lindur dhe rritur në Voksh të Deçanit. Në moshën 18-vjeçare, konkretisht në vitin 1994, kam emigruar në Kristiansand të Norvegjisë. Këtu kam vijuar studimet pranë Universitetit të Agder, në Shkenca Politike, niveli master. Shqiptarët në mërgim janë bashkuar në organizime e në shoqata të ndryshme ndër shekuj. Shoqata "Liria" është krijuar për t'i ruajtur dhe për t'i promovuar vlerat kombëtare në mënyrë të organizuar këtu në Kristiansand. Si shumë shoqata të tjera mërgimtarësh anekënd globit, edhe kjo shoqatë është krijuar për të dhënë një ndihmë në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave tona të shkëlqyera dhe për të zhvilluar një veprimtari të organizuar si komunitet shqiptar. Shoqata jonë është krijuar edhe për të qenë një zë i fortë i trojeve tona (shumë prej tyre) atëherë të robëruara. Ishte grupi iniciues në krye me Shefqet Pepën që i

dhanë shoqatës sonë emrin "Liria" në vitin e largët 1987. "Liria" është udhëhequr gjithmonë nga kryesia kolegjiale e kryesuar nga kryetarët si vijon: Daut Haxhaj, Sahit Shala, Esat Osmani, Mexhid Veliqi, Anton Ahmetaj, Canë Hasanaj, Ymer Berisha, Agron Daka, Ajat Gorqaj dhe nga viti 2017 nga unë Bashkim Hadërgjonaj. Shoqata "Liria" ka statusin e saj demokratik, i përpiluar/formatizuar më 20 janar 1993 nga komisioni i posaçëm për statutin, i përbërë nga Shemsije Hoti, juriste e diplomuar, Ibrahim Kasapolling, i diplomuar dhe Mexhid Veliqi, inxhinier i diplomuar, të cilëve u jemi shumë mirënjohës. Statuti është zbatuar/respektuar gjithmonë, në pikë e presje, nga të gjitha kryesitë e shoqatës. "Liria" ka klubin e Futbollit FC "Liria" që udhëhiqet nga presidenti Mentor Rashica dhe zëvendëspresidenti Florim Nikqi. Klubi i bashkon të rinjtë, organizon turnirë futbollit dhe është një arenë që i bashkon shqiptarët. Gjatë këtyre 34 vjetëve Shoqata "Liria" ka zhvilluar një varg veprimtarish të llojllojshme falë angazhimit këmbëngulës të veprimtarëve të

shoqatës sonë. "Liria" ka organizuar veprimtari të panumërta atdhetare, sensibilizuese, ekspozita, veprimtari kulturore, festive, radiofonike, gazetareske, mbështetje financiare në mbledhjen e 3-qindëshit, demonstrata në përkrahje të popullit dhe ushtrisë sonë të lavdishme çlirimtare, mbështetje financiare fondit "Vendlindja thërret", përvjetor dhe aktivitete sportive. Anëtarë të devotshëm të shoqatës sonë kanë mbajtur gjallë me vite të tëra gjuhën shqipe të një pjesë e fëmijëve tanë këtu. Është ky një rrugëtim i bukur 34-vjeçar, janë këto vitet e përpjekjeve tona, janë vite të një pune të palodhshme e të pandërprerë vullnetare dhe plot përkushtim për t'i arritur synimet dhe qëllimet tona. Kërkoj ndjesë nëse kam harruar pa përmend ndonjë. Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjitha ato/ata që kontribuuan ndër vite.

"Epoka e re": Sa anëtarë e përbëjnë kryesinë dhe sa janë vajza/gra?

Hadërgjonaj: Shoqata Kulturore Shqiptare "Liria" numëron qindra anëtarë dhe anëtare në Kristiansand dhe rrethinë. Numri i anëtarëve të kryesive ka ndryshuar ndër vite. Kryesia e tashme e Shoqatës "Liria" përbëhet prej tetë personash nga të cilët tre janë të gjinisë femërore. Kryesia ka, gjithashtu, një grup/formal mbështetës prej 15-20 personash. Gratë shqiptare në Kristiansand kanë qenë dhe janë shtyllat e të gjitha organizimeve/aktiviteteve të shoqatës që nga themelimi.

"Epoka e re": Cili është roli i shqiptarëve në vendin ku jetoni?

Hadërgjonaj: Shqiptarët në Kristiansand japin kontribut të

rëndësishëm dhe të përditshëm në shoqërinë norvegjeze dhe mbledhin përvoja të rëndësishme që mund e do të na shërbejnë për arritje dhe përparim në komunitetin tonë. Më lejoni t'ju them disa fjalë për shqiptarët këtu në Kristiansand. Unë i njoh mirë shqiptarët këtu dhe mund t'ju them me plot bindje se janë njerëz që mendja dhe zemra u rrahë për familjen, vendlindjen, atdheun, kombin dhe gjuhën tonë.

Shqiptarët këtu i gjënë në të gjitha profesionet dhe në të gjitha nivelet e administratës. Duke filluar nga ligjërues universitetesh siç janë Abit Hoxha, Brikena Djepaxhija, doktoresha Verona Ahmetaj, poeti dhe mësuesi Sahit Shala, dhe profesori Elvis Duro. Shqiptarët janë kudo. Këtu e gjeni ish-futbollistin e Kombëtares së Kosovës, Avni Pepa, futbollistët e njohur Wilhem Pepa e Dardan Dreshaj etj., ish-hendbollistët e Kombëtares së Kosovës, Merlinda Qorraj, hendbollistja e ardhshme e Kombëtares së Norvegjisë, Elvina Qorraj, Këngëtarët Hata Koca, Naser Hajdini dhe Leonida Dreshaj.

Sipërmarrës të suksesshëm si Fitim Pepshi, Shpend Hasanaj, Demi Hansen, Jeton Sejfiqaj, dhe Fisnik e Mentor Rashica. Pastaj vëllezërit Tahiraj, vëllezërit Vejsa, vëllezërit Rama, Valmir Avdiqaj, Zenel Hoxhaj, Adem Veseli e shumë e shumë profile të tjera. Kemi mbi 40 bashkatdhetarë të punësuar në transportin publik, pa të cilët kjo infrastrukturë kritike vështirë që do të mbijetonte. Gjeneratat e reja studiojnë në universitetet dhe institucionet e tjera arsimore të të gjitha niveleve dhe i gjënë të punësuar në të gjitha nivelet e administratës shtetërore dhe kompanive private.



"Epoka e re": Sa i përket mësimit në gjuhën shqipe, a ka shkollë shqipe në vendin ku jetoni?

Hadërgjonaj: Shoqata "Liria" po bën përpjekje për të themeluar shkollën shqipe për mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Besojmë se shumë shpejt, në dhjetor 2021 ose janar 2022, do të fillojmë mësimin plotësues në gjuhën shqipe për nxënësit e klasave të ulëta. Shkolla shqipe do ta mbajë emrin "Liria". Hëpërhë kemi mungesë të teksteve/librave shkollorë në gjuhën tonë. Po përpiqemi të sigurojmë tekste/libra shkollorë në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Oslo dhe shoqatat e tjera shqiptare këtu në Norvegji. Kemi mungesë të mësuesve vullnetarë të ciklit të ulët. Ne si

shoqatë kemi vështirësi të mëdha për të siguruar të ardhura për mësuesit.

"Epoka e re": Megjithëse në rrethana pandemie, a keni zhvilluar ndonjë aktivitet kohën e fundit dhe çfarë planesh keni për festat kombëtare?

Hadërgjonaj: Aktivitetet tona gjatë pandemisë kanë qenë shumë të kufizuara për shkak të kufizimeve dhe moslejimit të zhvillimit të aktiviteteve me shumë pjesëmarrës. Morëm vendim që gjatë pandemisë lokale tona të hapen nga grupe të vogla për të qenë sa më të sigurt për mbajtjen e distancave dhe kufizimeve të tjera për ta mbrojtur shëndetin publik. Megjithatë, jemi organizuar dhe kemi pritur këtu në Kristiansand rjetin e bizneseve

të diasporës shqiptare. Më tutje, kemi pritur në mënyrë madhështore ambasadorin e parë dhe fuqiplotë të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë, shkëlqesinë e tij, zotëri Uliks Emra, para pak muajsh. Tani shpresojmë që pandemia të kalojë dhe gradualisht t'i kthehemi jetës normale. Së afërmi do ta festojmë 28 nëntorin, festën tonë kombëtare. Më pastaj do të hapim shkollën shqipe "Liria", për të vijuar më 17 shkurtin, festimin e pavarësisë së Kosovës dhe festën e 8 marsit për gruan shqiptare. Para pushimeve verore planifikojmë edhe pjesëmarrjen tonë në festivalin ndërkombëtar të organizuar nga komuna e Kristiansand dhe kështu me radhë.

Mbrojtësit e Krasniqit dhe të Selimit apelojnë vendimet mbi mocionet për defektet në aktakuzë

HAGË, 16 NËNTOR - Avokatët mbrojtës të Jakup Krasniqit dhe të Rexhep Selimit kanë apeluar vendimin e gjyqarit paraprak lidhur me mocionet e tyre, ku pretendojnë për defekte në aktakuzë. Në parashtrësën e mbrojtësit të Krasniqit është thënë se gjyqtari i procedurës paraprake i ka dhënë mbrojtjes leje për ankesë për nëntë çështje që kanë të bëjnë me dështimin e aktakuzës, për t'i deklaruar faktet materiale me specifikë të mjaftueshme për t'i dhënë Krasniqit njoftimin e kërkuar për rastin kundër tij.

"Aktakuza dështon të deklarojë saktësisht se çfarë pretendohet se ka bërë z. Krasniqi. Pjesëmarrja e tij personale, e supozuar në krime, kontributi i tij i supozuar në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK) dhe përgjegjësia e tij e supozuar në përputhje me mënyrat e tjera të përgjegjësive, të gjitha mbeten



qëllimisht të paqarta", është thënë në parashtrësë. Sipas mbrojtjes, kjo pasaktësi është parargjyqese për Krasniqin sepse pengon përgatitjen e tij dhe i lejon prokurorit të specializuar që ta trajtojë rastin e tij në gjykim, pa e njoftuar Krasniqin.

Mbrojtja ka pretenduar se në vendimin e gjyqarit paraprak është gabuar kur është konstatuar se aktakuza nuk ishte

me të meta. "Mbrojtja kërkon nga Kolegji i Gjykatës së Apelit që të korrigjojë këtë padrejtësi, të korrigjojë këto gabime, ta prishë vendimin e kundërshtuar dhe ta urdhërojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ta ndryshojë aktakuzën", është thënë nga mbrojtja e Krasniqit.

Ndërsa në ankesën e mbrojtjes së Rexhep Selimit është thënë se gjyqtari paraprak i ka dhënë leje për ta apeluar vendimin për

çështjet e mëposhtme. "Nëse pretendimet për kontribut jokriminal të ndërmarrjes kriminale së përbashkët në aktakuzën e konfirmuar, e bën atë të dëmtuar ose është çështje e ligjit për t'u ngritur në gjyq, nëse ZPS-së nuk i kërkohet të përcaktojë në mënyrë specifike se cilat krime bien përfundimisht brenda qëllimit të përbashkët kriminal dhe cilat jo kur pretendon përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale III në alternativë ndaj ndërmarrjes së përbashkët kriminale I", është thënë në parashtrësën e mbrojtjes së Selimit.

Më tutje, është thënë se i është dhënë leje të apelojë edhe për çështjen nëse ZPS-së i lejohet të pretendojë se çdo individ i përmendur në aktakuzë mund të jetë ose anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale ose një mjet i saj, nëse e deklaron këtë në

alternativë. "Nëse mënyra e përgjegjësisë me të cilën një vartës supozohet se ka kryer krime është fakt material që duhet të deklarohet në aktakuzë në një rast të bazuar në përgjegjësinë superiore; nëse përvijimi i Rregullës 86 (3) (b) mund të përdoret, në këtë rast specifik, për t'i dhënë të akuzuarit të dhëna themelore shtesë kur pretendimet faktike janë dhënë në aktakuzën e konfirmuar", është thënë se është çështja e fundit.

Ndryshe, më 9 nëntor, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi dhe Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Kadri Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor. Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

Mustafa për rezultatin e zgjedhjeve lokale: U vërtetuan mashtrimet e LV-së

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Ish-kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se zgjedhjet lokale dëshmuar se mashtrimet e Lëvizjes Vetëvendosje kanë dalë. Ai ka thënë se kryeministri Albin Kurti dhe presidentja Vjosa Osmani janë treguar arrogante ndaj opozitës dhe ndërkombëtarëve. Ish-kryeministri Mustafa ka thënë se është fat që Kurti dhe Osmani s'kanë fuqi sepse do ta shtynin Kosovën drejt luftës. "Këto zgjedhje u zhvilluan në një ambient shumë më normal krahasuar me ato nacionale të 14 shkurtit në të cilat u promovua një histori që ngjante me ato fashiste. Jo vetëm nga LV-ja dhe paterica e saj 'Guxo',

por edhe nga disa media. Zgjedhjet lokale dëshmuar se ky ballon po shfryhet, mashtrimet po dalin në shesh dhe qytetarët po dëshmohen se janë vlerësues racionalë në afat të gjatë. Për fat të keq, kam vërejtur se çdo gjë që e kanë kritikuar z. Kurti dhe znj. Osmani në të kaluarën e kanë bërë vetë gjatë kësaj kohe, pa asnjë konsideratë. Ajo që veçmas i veçon është një arrogancë jo vetëm ndaj opozitës dhe votuesve të tyre, por edhe ndaj ndërkombëtarëve. Fati që s'kanë shumë fuqi, se edhe në luftë do të na shtynin", ka thënë Mustafa për "Express". Më tutje, Mustafa ka thënë se



Vetëvendosja në zgjedhjet e ardhshme mund të mbetet partia e katërt. "Tani duhet të kthjellen sepse, nëse vazhdojnë kështu, në zgjedhjet e ardhshme LV-ja mund mbetet partia e

katërt, kurse 'Guxo' askund, si sot", ka thënë ai. Mustafa ka thënë se rikthimi i LDK-së në Prishtinë është i rëndësishëm edhe pse ka pritur që LDK-ja do të fitojë në Gjiilan,

Podujevë dhe Vushtrri. "Rezultatet e LDK-së janë të mira. Kam pritur se LDK-ja me meritë do të fitojë edhe Gjiilanin, Podujevën dhe Vushtrrinë. Ndryshimet, të cilat ndodhën në Prishtinë, i konsideroj shumë të rëndësishme jo vetëm për LDK-në. Se sa do të funksionojë drejtimi i Prishtinës varet shumë nga përkrahja e asamblesë komunale, nga drejtorët, por edhe nga përkrahja e qeverisë. Tani ka kaluar fushata së bashku me edicionin e premtimeve dhe fillon ballafaqimi me realitetin i cili nuk është i thjeshtë e as bardh e zi. Uroj të kenë sukses të gjithë kryetarët e komunave", ka thënë ai.

Vëzhguesit e BE-së vlerësojnë pozitivisht raundin e dytë të zgjedhjeve

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Misioni i vëzhguesve të zgjedhjeve nga BE-ja ka vlerësuar pozitivisht raundin e dytë të zgjedhjeve, i cili është mbajtur në 21 komuna të dielën. Në prezantimin e raportit për monitorimin e zgjedhjeve, shefi i këtij misioni, Lukas Mandl, ka thënë se procesi i votimit nga vëzhguesit është vlerësuar "shumë i mirë". "Në ditën e zgjedhjeve vëzhguesit e BE-së vizituan 269 vendvotime në tërë Kosovën në të 21 komunat ku u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve. Vëzhguesit e BE-së vlerësuan votimin dhe numërimin në mënyrë pozitive. Votimi u vlerësua si 'shumë i mirë' ose 'i mirë' në 99.2 për qind të vendvotimeve të vizituara në të 21 komunat dhe numërimi u vlerësua si 'i mirë' apo 'shumë i mirë' në të gjitha vendvotimet e vizituara



edhe pse ka pasur ca vështirësi në përputhshmërinë e fletëvotimeve në 1/3 e vendvotimeve të vëzhguara", ka deklaruar ai. Mandl ka deklaruar se partitë politike dhe kandidatët kanë filluar fushatën zgjedhore shumë kohë para periudhës zyrtare prej pesë ditësh. "Fushata ishte dinamike, e gjallë dhe e qetë. Edhe pse toni i fushatës ishte pak më i ashpër sesa në raundin e parë. Në

mungesë të ndëshkimeve për zhvillim të fushatës jashtë periudhës zyrtare pesëditore shumica e kandidatëve filluan ta kërkojnë votën shumë para se të fillojë fushata zyrtare. Në tubimet e kandidatëve morën pjesë udhëheqësit e partive kryesore, përfshirë kryeministrin dhe ministrat. Në mes të dy raundeve qeveria shpalli një rritje të përkohshme të përfitimeve sociale që dërgoi në akuzat e opozitës për blerje

indirekte të votës. Mungesa e hapur e transparencës që lidhet me financimin e fushatave të garuesve vazhdoi edhe në raundin e dytë, duke vazhduar zbatimin e dobët të rregullave për financim të fushatës. Kuvendi i Kosovës nuk pati mundësi të garantojë auditimin me kohë të raporteve dhe KQZ-ja nuk mbështeti sa duhet zbatimin e rregulloreve që janë në fuqi", ka deklaruar ai. Shefi i misionit të vëzhguesve të BE-së ka deklaruar se tabela e rezultateve të raundit të parë vuri në pah një dobësi të theksuar në numërim dhe plotësim të formularëve të rezultateve. Sipas tij, rinumërimi i 1 000 vendvotimeve ka treguar nevojën për një rishikim gjithëpërfshirës të dizajnit të fletëvotimeve dhe të formularëve të rezultateve. Ai ka folur edhe sa i përket paraqitjes së kandidatëve në

media. "Mediat publike ofruan një mbulueshmëri të balancuar dhe u përpoqën të organizojnë debate me kandidatët për të gjitha 21 komunat edhe pse shumica e kandidatëve vendosën që të mos marrin pjesë. Mediat private intervistuan kandidatët në mënyrë të rregullt dhe ia dolën të mbajnë disa debate. Mediat e transmetuara u përmbajtën nga transmetimi i përmbajtjeve të paguara politike jashtë fushatës zyrtare zgjedhore duke respektuar rregulloren, megjithatë disa kanale televizive publikuan sondazhe të pabesueshme. Derisa kandidatët dhanë informacione të dobishme përmes platformave online, disa faqe jo transparente të 'Facebook'-ut u përdorën që të përhapin përmbajtje çorientuese që ndikuan në mundësinë e votuesve për të marrë vendime pa ndërhyrje", është shprehur Mandl.

Kërkohet të hetohen votat e ardhura nga diaspora

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është kërkuar të hetohen votat të cilat kanë ardhur jashtë vendit për shkak të dyshimeve për manipulimin e tyre. Anëtarë i PDK-së në KQZ, Arianit Elshani, ka thënë se i ka parë disa nga fletëvotimet që janë duke u ruajtur në Ministrinë e Transportit dhe, sipas tij, duket qartë se një numër të madh të tyre i ka plotësuar i njëjti person. "Në zgjedhjet e shkurtit kemi filluar numërimin për votat nga jashtë, mandej me kusht, me

qëllimin e vetëm që të kemi qartësi. Është mirë të na sqarojë sekretariati. Sa i përket çështjes me votat nga jashtë për tri komuna, Mamushë, Junik dhe Dragash, janë dukshëm më të vogla. Prandaj edhe sot isha në Ministri të Transportit dhe i kam parë. Duket qartë që disa nga këto fletëvotime të dhënat aty i ka plotësuar i njëjti person. Prandaj këto kërkojnë një hetim dhe të verifikohen në qoftë se këta persona janë regjistruar. Është më se e nevojshme që këto aplikime t'i nënshtrohen një verifikimi nga



KQZ-ja. Duhet të bëhet një hetim nga KQZ-ja dhe të kemi një raport në bazë të qyteteve nga ku kanë ardhur ato", ka

thënë Elshani. Edhe Sami Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje ka thënë se është pro këtij propozimi. "Prej tri

komunave po na dalin më shumë. Një shumë aq e madhe e njerëzve konfirmojnë 0.3 për qind që nuk kanë aplikuar për shkak që ka hajna të votave, prandaj jam për t'u ndjekur procesi që të verifikohen", ka deklaruar Kurteshi. Edhe Florian Dushi nga LDK-ja ka thënë se duhet që të ketë verifikim të këtyre votave. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i sekretarit të KQZ-së, Burim Ahmetaj, ka thënë se në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është pranuar i gjithë materiali i ndjeshëm nga të gjitha komunat.

Të enjten Kuvendi mban seancë, opozita kritikon mazhorancën

Prishtinë, 16 nëntor (ER) - Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës ka dështuar të mbahet të martën për shkak të mungesës së kuorumit. Mirëpo me vendim të kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, seanca e radhës është caktuar të mbahet të enjten. Me këtë rast, ai ka thënë se në këtë seancë, përveç pikave të rendit të ditës do të zgjidhet edhe nënkryetari i Kuvendit nga radhët e PDK-së.

“Kjo është e disata herë që Kryesia e vendit nuk po mund të mbledhet dhe nuk po ka kuorum, mirëpo Kushtetuta e ka paraparë që Kuvendi i Kosovës nuk mund të bllokohet. Neni 67 i rregullores i lejon kryetarit të Kuvendit të thërras seancën. Vendosëm ta caktojmë seancën për pasnesër, më datë 18 nëntor në orën 10:00. Pastaj në këtë seancë pritet të zgjidhet edhe nënkryetari nga radhët e PDK-së, duke qenë se Bedri Hamza është zgjedhur kryetar i Mitrovicës”, ka thënë Konjufca.

Ai ka thënë se Lista Serbe është duke e bojkotuar qëllimshëm Kuvendin, por që nuk do të lejojnë asnjë kushtëzim e shantazh nga kjo parti. “Lista Serbe po e bojkoton qëllimshëm dhe në

mënyrë të vazhdueshme, ne nuk pranojmë asnjë shantazh, e aq më pa në mënyrë publike. Simiqi po vjen e në momenti që po e sheh që ne bashkë me të po jemi katër anëtarë të Kryesisë ai po largohet që mos të mund të merren vendime. Ai këtë e ka bërë edhe sot. Me këtë Lista Serbe po tregon kushtëzim, por ku kushtëzim nuk pranohet”, ka thënë Konjufca.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës dhe pozitën për mungesë të angazhimit në agjendën legjislative. Pas dështimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Tahiri ka thënë para mediave se nga mazhoranca nuk është duke u parë rritje e angazhimit për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve. “Sa i përket funksionimit të Kuvendit, jemi dëshmitarë që nuk kemi pasur një mbarëvajtje të duhur. Normalisht që përgjegjësia bie mbi mazhorancën që është treguar joefikasë në shumë aspekte. Nuk që nga fillimi kemi arritur të kemi një funksionim të mirëfilltë që do t'u përgjigjej nevojave të qytetarëve. Rol të madh ka edhe qeveria, pasi është proceduesja më e madhe e agjendës legjislative. Prandaj



ka shumë të meta. Pra mosfunksionimi i saj ka dëmtuar shumë parti, pasi janë mbetur pezull shumë projekte të ndryshme. Prandaj prej fillimit nuk kemi parë angazhim për përmirësim të efikasitetit”, ka thënë Tahiri, duke shtuar se PDK-ja në vazhdimësi është treguar e përkushtuar. Më tutje, Tahiri ka theksuar se shumë shpejt PDK-ja do të përcaktohet për nënkryetarin në Kuvend, pas dorëheqjes së Bedri Hamzës.

Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se Kuvendi tash e sa muaj është i bllokuar. Ai ka thënë se ka shumë ligje të rëndësishme që presin të trajtohen e që për shkak të mungesës së kuorumit nuk po arrihet të procedohet tutje. Tahiri, pas dështimit të mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, ka thënë se nga mosmbajtja e seancave janë grumbulluar afër 40 pika të rendit të ditës e që, sipas tij,

për trajtimin e tyre duhen të paktën katër ditë. Tahiri ka thënë se kjo nënkupton që shumica parlamentare ka probleme serioze me menaxhimin e përgjegjësi që kanë marrë si në Kuvend, po ashtu edhe në qeveri. Më tutje, ai ka folur në lidhje me Ligjin për Pagat në sektorin publik. Ai ka thënë se miratimi i këtij ligji është shumë i rëndësishëm për vendin, sidomos në këtë kohë kur janë rritur çmimet e prodhimeve.

Presidentja Osmani: Qytetarët e Kosovës u besojnë grave

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se vajzat dhe gratë janë bosht i promovimit të paqes dhe në politikën e mbrojtjes. Ajo ka deklaruar se qytetarët e Kosovës i besojnë fuqisë së gruas. “Duke qenë vetë një grua bartëse e përgjegjësi shtetërore, besoj fuqishëm dhe nënkupton promovim të mëtutjeshëm të rolit të grave dhe vajzave në shoqëri se, para së gjithash, pjesëmarrja jo vetëm që është e dukshme, por është vendimtare dhe përcaktuese për orientim të politikave të drejta”, ka deklaruar Osmani.

Këto komente ajo i ka bërë në konferencën me temën “Roli i grave në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë”, e cila është organizuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me UN-Women me rastin e përvjetorit të miratimit të Rezolutës 1325 e OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë. Sipas shefes së shtetit, pavarësisht prej progresit që është bërë, gratë në Kosovë

ende vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha. “Edhe pse kemi shumë punë, është evidente që Kosova ka shënuar rezultate të grave në vendimmarrje, por edhe në zbatimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë. Që nga Ligji për Barazi Gjinore e shumë dokumente e marrëveshje të tjera të hartuara më parë e që do të hartohen tash e tutje në vendin tonë, flet për mundësinë e barabartë të grave në Kosovë”, ka thënë Osmani.

Ndërsa Ulrika Richardson, koordinatore për zhvillim e OKB-së në Kosovë, ka thënë se gratë mbeten pak të përfaqësuara në proceset vendimmarrëse. Sipas saj, me pjesëmarrjen e grave në çdo proces ekonomia rritet, jostabiliteti dhe ekstremizmi ulet. “Kanë kaluar 21 vjet prej kur Këshilli i OKB-së ka miratuar Rezolutën 1325 për gratë, paqen dhe sigurinë, ku siguria është esenciale e kësaj rezolute. Ne e dimë që gratë janë pak të përfaqësuara në proceset vendimmarrëse. Me



pjesëmarrjen e tyre ekonomia rritet, jostabiliteti dhe ekstremizmi ulet, dhe kjo nënkupton se nga angazhimi i grave shohim rezultate dhe paqe që zgjatim më shumë. Tradicionalisht, policia është e dominuar nga meshkujt, është parim apo pjesë integrale e

qeverisë. Parimi i barazisë gjinore është gjysma e zotimeve që i jep rezoluta. Mbetet shumë punë për t'u bërë, por ka pasur integritet të kësaj agjende në Kosovë, siç është rritja e numrit të grave në polici dhe ushtri”, është shprehur ajo. Në anën tjetër, ministri i MPB-

së, Xhelal Sveçla, ka thënë se baza e themelimit të shtetit është ndërtuar nga sakrificat e grave dhe burrave në përballje me Serbinë. Për krimet e kryera ai ka thënë se Serbia as nuk ka kërkuar falje dhe as nuk i ka dënuar kryesitë këtyre veprave.

Kryetarit të Prishtinës nuk do t'i mjaftojë buxheti

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Planprogrami i kryetarit të ri të Prishtinës, Përparim Rama, nuk mund të realizohet me një buxhet prej rreth 90 milionë eurosh në vit, por do të duhen grante, kredi të buta ose donacione nga mekanizmat financiarë ndërkombëtarë, thonë përfaqësues të organizatave që merren me politika lokale.

Rama nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka fituar garën për kryetar të kryeqytetit në rundin e dytë të zgjedhjeve lokale në Kosovë, që është mbajtur më 14 nëntor. Ai ka mposhtur ish-ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili ka garuar si kandidat i partisë në pushtet - Lëvizjes Vetëvendosje.

Në planprogramin e Ramës për katër vjetet e ardhshëm figuron ndërtimi i rrugëve, objekteve shkollore, çerdheve, qendrave të mjekësisë familjare, galerisë së qytetit, strehimoreve për

qentë endacakë e projekte të tjera.

Qëndrim Arifi, hulumtues i Organizatës Iniciativa për Progres në Kosovë, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se projektet e Ramës janë ambicioze. "Nëse ndalemi vetëm në buxhetin e komunës, ato projekte janë të pamundura të bëhen, sepse për projekte kapitale për katër vjet, komuna e Prishtinës mund t'i ketë afërsisht 200 milionë euro. Nëse e marrim programin e Ramës, ai është shumë më i lartë për nga aspekti buxhetor", ka thënë Arifi.

Buxheti i planifikuar i komunës së Prishtinës për vitin 2021 është 85 712 836 euro.

Sa i përket kategorisë së shpenzimeve, pjesa më e madhe e buxhetit të komunës së Prishtinës shpenzohet për paga dhe mëditje: 36 për qind. Për shpenzime kapitale, ndërkaq, ndahen 31 për qind.



Për vitin 2022 buxheti i projektuar i komunës së Prishtinës është mbi 90 milionë euro. Arifi ka thënë se projektet kapitale, të paraqitura nga Rama, mund të realizohen vetëm me ndihmën e fondeve që mund të merren nga

institucionet financiare ndërkombëtare.

Në programin e tij katërvjeçar, Rama ka planifikuar që mbi 50 për qind e buxhetit total të ndahen për investime kapitale në kryeqytetin me mbi 218 000 banorë. Në debate publike ai ka

sqaruar se realizimin e projekteve të tij e mbështet edhe në marrjen e granteve dhe kredive nga mekanizmat ndërkombëtarë financiarë. "Se sa do të mund Rama dhe kabineti i tij të marrin fonde nga jashtë, mbetet të shihet", ka thënë Arifi. Për Sadri Rrmokun, nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, projektet e kryetarit të ri janë relativisht të zbatueshme nëse shihen projeksionet buxhetore të komunës së Prishtinës dhe mundësitë e tjera që i ka ajo "për shkak se buxheti i komunës së Prishtinës për investime kapitale për vitin 2022 është projektuar të jetë mbi 31 milionë euro. Edhe projeksionet e buxhetit për [investime kapitale] për vitin 2023 janë 43 milionë euro, por ka edhe mundësi të tjera financiare, siç është partneriteti publiko-privat, [apo] përmes fondeve zhvillimore ndërkombëtare", ka thënë Rrmoku.

"Kosova vështirë se do t'i përmbushë objektivat e agjendës së gjelbër"

Drejtori i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Janez Kopac, ka thënë se, përveç Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Shqipërisë, vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, do ta kenë të vështirë t'i arrijnë objektivat e përcaktuara në Agjendën e Gjelbër të Bashkimit Evropian (BE).

Komuniteti i Energjisë është organi rregullator i BE-së në fushën e energjisë. "Mendoj se sukses do të kenë Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, sepse të dyja vendeve u mbaron qymyri, ndërsa Shqipëria sigurisht do t'ia dalë. Mirëpo, Kosova, Bosnjë dhe Hercegovina dhe Serbia, nëse nuk fillojnë së shpejti zbatimin e taksës së karbonit, nuk kanë mundësi që të arrijnë këtë qëllim deri në vitin 2050", ka thënë Kopac.

Ai deklarantën e ka bërë në një konferencë online në të cilën është paraqitur raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të



rregulloreve evropiane të energjisë nga vendet nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si pjesë

e përpjekjeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Raporti mbulon Kosovën, Shqipërinë, Bosnjë dhe

Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Gjeorgjinë, Moldavinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Ukrainën në periudhën nga

nëntori 2020 deri në nëntor 2021.

Sekretariati i KE-së në raportin e tij ka lavdëruar Kosovën për vazhdimin e politikave që çojnë drejt përdorimit të vazhdueshëm të energjisë së pastër duke vënë theksin te shtyrja e planeve për ndërtimin e një termocentrali të ri me qymyr.

Megjithatë, raporti ka theksuar se energjia elektrike e prodhuar nga era dhe dielli është ende në nivel të ulët në Kosovë. Kosova është pothuajse plotësisht e varur nga dy fabrika të vjetruara të linjtit për prodhimin e energjisë elektrike.

Gjithashtu, aty theksohet se Kosova nuk është e lidhur me asnjë sistem të transmetimit të gazit natyror (gazsjellës).

Intensiteti energjetik i ekonomisë së Kosovës është pothuajse katër herë më i lartë se mesatarja në nivel të BE-së, është thënë në raport.

Mospagesa e rrymës në veri, Kurti: Fajin e kanë strukturat paralele

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se fajin për mospagesën e energjisë elektrike në veri të vendit e kanë strukturat paralele atje. Kurti ka thënë se licencimi i kompanisë së shpërndarjes së rrymës në këtë pjesë është përgjegjësi e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë). "Për sa i përket mospagesës së rrymës në veri, fajin e kanë strukturat paralele

atje, sepse sa më shumë që ka struktura paralele të Serbisë në këto vite, pas çlirimit e pas pavarësisë, aq më pak ka ligjshmëri. Licencimi i kompanisë është kompetencë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe ata do ta bëjnë vendimin për këtë", ka thënë Kurti të martën gjatë prezantimit të ministrit të ri të Shëndetësisë.

Ai ka thënë se për çështjen e energjisë në veri duhet të

bisedohet me Brukselin e jo me Beogradin. "Për çështjen e energjisë në veri ne mund të bisedojmë me Brukselin e jo me Beogradin. Kjo është një çështje e Kosovës. Duke e ditur se Bashkimi Evropian ka qenë i impenjuar në këtë temë, me të mund të bisedojmë. Prandaj, nëse kjo temë ngrehet atje, atëherë ngrehet në raportin Prishtinë - Bruksel e jo me raportin Prishtinë - Beograd", ka thënë kryeministri Kurti.



Ja pse funksionon keqinformimi mbi Covid-19



Nga Noam TITELMAN

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në muajin shtator, presidenti brazilian Zhair Bolsonaro e shfrytëzoi fjalimin e tij, për të treguar pikëpamjet e tij mbi Covid-19. Ai lavdëroi vetitë e trajtimeve që janë refuzuar aktualisht nga shkencëtarët, dhe deklaroi se ai vetë kishte përfituar nga ilaçi kundër malaries, hidroksilklorina.

Mbështetja e Bolsonaro për "kura të tilla që bëjnë mrekulli" është e njohur. Ai është shfaqur rregullisht në shtypin brazilian dhe në rrjetet sociale, duke promovuar përdorimin e trajtimeve që nuk kanë asnjë bazë tek faktet shkencore. Por ai nuk është i vetmi në këtë drejtim.

Covid-19.

Dhe për dëshpërimin e komunitetit shkencor, këta politikanë por dhe të tjerë kanë bindur me sukses një pjesë të madhe të publikut mbi "efikasitetin" dhe "sigurinë" e trajtimeve të tilla.

Keqinformimi është përhapur shumë gjatë kësaj pandemie, por ai nuk është ndonjë fenomen i ri.

Në punën e tyre kryesore mbi perceptimin e mirëqenies në Shtetet e Bashkuara, politologu Xhejms Kuklinski dhe kolegët e tij, treguan se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë amerikane, kishte perceptime të pasakta mbi përfituesit e mbështetjes shtetërore dhe sasinë e parave që ata merrnin.

Po ashtu ata zbuluan se përhapja e keqinformimeve, pengoi vëmendjen e duhur ndaj informacionit të saktë. Njerëzit e keqinformuar, nuk kanë thjesht informacione të pasakta; ata janë shumë të investuar në keqkuptimet e tyre. Dhe kjo është ajo që e bën kaq të fuqishëm keqinformimin: ai kombinon keq-perceptimet mbi botën, me një shkallë të lartë

besimi mbi saktësinë e tyre.

Njerëzit nuk i besojnë informacionit të rremë për shkak se janë injorantë. Në këtë proces ndikojnë shumë faktorë në punë. Por shumica e studiuesve, bien dakord se besimi tek keqinformimi, ka pak të bëjë me sasinë e njohurive që zotëron një person.

Keqinformimi duket se është një shembull kryesor i arsytimit të motivuar. Pra njerëzit priren që të arrijnë në përfundimet që duan, për aq kohë sa mund të ndërtojnë justifikime në dukje të arsyeshme për këto rezultate. Një studim i botuar në vitin 2017, tregoi se njerëzit që kanë dije dhe një arsimim më të madh shkencor, kanë më shumë gjasa të mbrojnë besimet e tyre të polarizuara, në lidhje me tema të diskutueshme shkencore për shkak të "shqetësimeve jo-shkencore".

Dhe një nga këto shqetësime më të fuqishme është ruajtja e identitetit. Udhëheqësit politikë janë më efektivët në nxitjen e keqinformimeve, kur shfrytëzojnë frikën e qytetarëve se mos humbin ato që ata i perceptojnë si aspekte

përcaktuese të kulturës së tyre, sidomos gjuhën, fenë dhe hierarkitë dhe rolet racore dhe gjinore.

Në mjediset e polarizuara politike, vëmendja që fiton keqinformimi ka të bëjë pak me nivelet e ulëta të njohurive apo angazhimit, dhe më tepër me mënyrën se si informacioni interpretohet në një mënyrë që të përputhet me identitetin ideologjik.

Qasja "ne kundër tyre", nënkupton se pjesët e ndryshme të informacionit që marrin njerëzit, përpunohen në një mënyrë, e cila i përshtatet botëkuptimit të tyre. Kjo është arsyeja pse nga të njëjtat fakte, individët mund të nxjerrin përfundime çuditërisht të ndryshme.

Kur liderët politikë mbështetin trajtime të paprovuara ndaj Covid-19, ata janë duke përfituar nga kjo tendencë polarizuese. Por një fokus i tepruar tek këta liderë, mund të errësojë arsyen kryesore që i ka nxitur njerëzit t'i pranojnë këto mesazhe.

Gatishmëria për ta besuar keqinformimin, i ka rrënjët tek aspektet themelore të identitetit

kulturor, të cilat manipulohen nga politikanët. Studimi i fundit nga Mariana da Silva, studente postdoktorale në Universitetin e Oksfordit, ka treguar se një nga arsyet pse brazilianët u besojnë trajtimeve si ato të promovuara nga Bolsonaro, është një besim i thellë kulturor se një "mjek serioz" është ai që jep ilaçe.

Bolsonaro nuk kishte nevojë që t'i bindte brazilianët mbi përfitimet e ivermektinës dhe klorokinës. Mjaftoi që ai të konfirmonte se sëmundjet potencialisht serioze, duhet të trajtohen gjithmonë me ilaçe. Ai ofroi një narrativë, e cila i lejoji disa segmente të popullsisë të arrinin në përfundimin e dëshiruar. Dhe kaq mjaftoi.

Të kuptuarit e faktorëve nxitës të keq-informimeve është thelbësor për parandalimin e përhapjes së tij. Për t'i mbajtur njerëzit të sigurt nga Covid-19, dhe për të inkurajuar vaksinimin, nuk mjafton vetëm denoncimi i politikanëve që promovojnë informacionet erreme. Ne duhet gjithashtu të kuptojmë motivet themelore, që i nxitin njerëzit t'u besojnë atyre. / "Project Syndicate" – Bota.al

QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Astera dhe Dea transferohen në ShBA

Basketbollistët e Kosovës, Astera Tuhina dhe Dea Pushkolli karrierën basketbollistike do ta vazhdojnë në ShBA. Basketbollistët 17-vjeçarë vlerësohen me perspektive të madhe për të ardhmen e Përfaqësueses së Kosovës. Tuhina ka nënshkruar për Washington State Cougars, kurse Pushkolli ka nënshkruar kontratë me The Duquesne Dukes



PRISHTINË, 16 MARS - Një hap i madh për Astera Tuhinën, nënshkruan për Washington State Njëra nga basketbollistët më të talentuara të Kosovës, Astera Tuhina ka bërë një hap të madh në karrierën e saj. Tuhina ka nënshkruar për Washington State Cougars në ShBA, ku do të garojë në NCAA Divizion 1. Astera do të jetë pjesë e Washington State nga edicioni i ardhshëm. Ajo do të vazhdojë të luajë në Spanjë, te skuadra Deportivo Promete, ku ka luajtur edhe në Superligën spanjolle, një sukses i madh për basketbollistën e Kosovës. Trajnera e Washington State, Kamie Ethridge është shprehur shumë e lumtur për nënshkrimin me basketbollistën e Kosovës, duke e lavdëruar atë dhe duke shtuar se do të jetë pjesë e rëndësishme për edicionin e ardhshëm. "Ajo ka pasion, këmbëngulje, ashpërsi dhe një përpjekje të pamëshirshme për të bërë gjithçka që duhet që ekipi i saj të ketë sukses. Ajo mund të gjuajë për 3 pikë dhe ajo është shumë kreative në lëvizjet e saj drejt koshit. Energjia me të cilën

luan Astera është ngjithëse dhe tifozët tanë do ta pëlqejnë sa fort luan. Jemi të emocionuar që kemi fituar besimin e Asterës dhe familjes së saj. Ajo do të jetë një shtesë e shkëlqyer për familjen tonë", u shpreh Ethridge. Astera Tuhina është vetëm 17 vjeçare dhe ka luajtur për të gjitha grupmoshat e Kosovës, si dhe ka debutuar për Kosovën A në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në Qipro, si basketbollistja më e re. Gjatë verës

së fundit ishte edhe pjesë e Kosovës U20. Ndërsa edhe basketbollistja e talentuar e Kosovës, Dea Pushkolli ka bërë një hap të madh në karrierën e saj, duke nënshkruar kontratë me The Duquesne Dukes dhe do ta përfaqësojë ekipin e universitetit të Duquesne. Kjo skuadër ndodhet në Pitsburg të Pensilvanisë në NCAA divizionin e parë të basketbollit. Ky është një hap i madh për basketbollistën e Kosovës, që me punë shpreson të arrijë në nivelet e larta të basketbollit amerikan. Ajo është shprehur shumë e lumtur për nënshkrimin e kontratës, duke premtuar maksimumin dhe të arrijnë suksese së bashku. Dea më herët ishte pjesë e Rock HS të Floridës, ndërsa ishte pjesë e grupmoshave të Kosovës dhe shihet si një basketbolliste me të ardhme të ndritur dhe që do t'i ndihmojë Kosovës A. Pushkolli është vetëm 17 vjeçare, ndërsa së fundi ishte pjesë e Kosovës U20 në FIBA European Challenger në Shkup të Maqedonisë Veriore.



SHKURT

Rifati, pjesë e shtabit teknik të Përfaqësueses së Kosovës

Trajnieri i Prizrenit 16, Arbnor Rifati, është emëruar ndihmëstrajner në Përfaqësuesen A të Kosovës. Rifati ka drejtuar me sukses skuadrën prizrenase në vitet e fundit, derisa së fundi fitoi Superkupën e Kosovës në basketboll. Në edicionin e kaluar drejtoi prizrenasit në vendin e parë në garat e rregullta. Rifati më herët ka qenë gjyqtar në Superligës si dhe menaxher, duke transferuar shumë basketbollistë në Kosovë dhe më gjerë. Rifati i bashkohet shtabit teknik të Përfaqësueses së Kosovës dhe në bashkëpunim me ndihmësit e tjerë dhe përzgjedhësin Christos Marmarinos do të përpiqen të kenë rezultate sa më pozitive me Kosovën. "Dardanët" më 25 nëntor do të përballen me Norvegjinë në udhëtim, ndërsa më 28 e presin në shtëpi Danimarkën. Këto dy ndeshje zhvillohen në kuadër të FIBA Eurobasket 2025.

Shaqiri, pas kualifikimit në Botëror: Është si ëndërr për mua

Kapiteni i Zvicrës, Xherdan Shaqiri, është shprehur i emocionuar pas ndeshjes kundër Bullgarisë. Zvicra e fitoi këtë ndeshje me rezultat 4-0 dhe u kualifikua në Botërorin e vitit të ardhshëm. "Është si ëndërr për mua. Unë kam shijuar secilën ndeshje në përfaqësuese. Të gjithë janë të lumtur, të gjithë janë krenarë. Rrallë ka ditë kaq të mira si sot. Ne ia dolëm. Ky ishte synimi ynë. Një falënderim i madh shkon për Murat Yakinin, që ka ecur gjurmëve të Vladimir Petkoviçit", ka thënë Shaqiri.

Prishtina arrin fitore të vështirë në Deçan

Prishtina është dashur ta përmbysë rezultatit në pjesën e dytë për ta fituar ndeshjen në udhëtim ndaj Deçanit. Në kuadër të javës së nëntë të Superligës, Prishtina fitoi me rezultat 33:30. Pas 30 minutave lojë rezultati ishte 19:16 për vendasit. Në pjesën e parë epërsia e Deçanit shkoi deri në pesë gola (17:12, 19:14), por Prishtina në pjesën e dytë u përmirësua dhe në minutën e 43-të barazoi rezultatit në 24:24. Sërish Deçani u shkëput në dy gola, ndërsa vetëm në minutën e 54-t Prishtina kaloi në epërsi, 29:28. Rezultati u barazua në 29:29 e më pas në 30:30. Por në katër minutat e fundit realizoi vetëm Prishtina që në fund fitoi ndeshjen dramatike me 33:30. Albi Gjuka realizoi golat vendimtarë për Prishtinën. Ai ndeshjen e mbylli me 5 gola. Kapiteni Oltion Beshiri realizoi 8 herë, ndërsa 7 gola i kishte Vlerson Zherka. Përparim Shala ishte më efikas te Deçani me 7 gola. 6 i shënoi Drilon Tahirukaj e nga 5 i kishin Dedë Tanushi e Valmir Selmanaj. Ndeshja tjetër e javës së nëntë në mes të Rahovecit dhe Llapit u fitua nga skuadra vendase me rezultat 31:24. 13:11 ishte rezultati pas pjesës së parë. Besmir Kusari e Egzon Vuçitërna shënuan nga 9 gola për Rahovecin. Mërgim Ademi realizoi 5 gola për llapjanët.

Shtyhet xhiroja e pestë në Ligën Unike

Prishtinë, 16 nëntor - Xhiroja e pestë e Ligës Unike e cila ishte paraparë të zhvillohej në fundjavën e ardhshme është shtyrë për 4/5 dhjetor. Shtyrja vjen me kërkesë të Federatës Shqiptare të Basketbollit për

shkak të grumbullimit të Kombëtares shqiptare në parakualifikimet e FIBA Eurobasket 2025. Kuqezinjët më 25 nëntor do të përballen me Luksemburgun në Durrës. Në xhiron e pestë të Ligës

Unike do të takohen Teuta - Tirana Neptun, Golden Eagle Ylli - Kamza Basket, Peja - Prizreni 16 dhe Vllaznia - Rahoveci. Pas katër xhirove Teuta, Prizreni 16 dhe Golden Eagle Ylli kanë nga tri fitore

dhe një humbje, Peja, Kamza Basket dhe Tirana Neptun kanë nga dy fitore dhe dy humbje, Vllaznia e Shkodrës ka një fitore dhe tri humbje, ndërsa Rahoveci ka katër humbje.



Shqipëria mbylli kualifikueset e Botërorit, Rama: Faleminderit për emocionet që na dhuruat!

TIRANË, 16 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë e ka mbyllur me fitore minimale ndaj Andorrës në "Air Albania" rrugëtimin për Botërorin Katar 2022. Pa dyshim që ky ishte një nga edicionet më të mira të "kuqezinjve" pasi kurrë më

parë nuk ia arritën të grumbullonin 18 pikë dhe të përfundojmë në vendin e tretë pas Anglisë dhe Polonisë. Në rrjetin social "Facebook" ka reaguar kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili ka falënderuar futbollistët dhe trajnerin për

emocionet e bukura që dhuruan. "Kombëtarja kuqezi nuk është e jona vetëm kur fiton, por edhe kur humbet dhe ky i kësaj radhe mbetet një edicion i bukur i kuqezinjve, për të cilin të gjithë djemtë e kësaj skuadre dhe trajneri ynë meritojnë

falënderime për emocionet që na dhuruan e respekt për të 18 pikët që grumbulluan. Me grupin plot të rinj dhe përvojën e fituar në këto eliminatore, më e mira është ende përpara për këtë kombëtare", ka shkruar Rama.



Reja: Shqipëria është rritur, kemi treguar që mund të përballemi me çdo kundërshtar

TIRANË, 16 NËNTOR - Shqipëria ka triumfuar me rezultatin minimal 1-0 në stadiumin "AIR Albania" ndaj Andorrës, duke e mbyllur në vendin e tretë fushatën kualifikuese të Botërorit "Katar 2022". Pas ndeshjes trajneri i kombëtares shqiptare, Edi Reja për "FSHForG", ka analizuar këtë ecuri të kuqezinjve, por duke theksuar dhe objektivat e së ardhmes. "Ka qenë një fushatë e rëndësishme eliminatorësh. Pa diskutim që ne jemi rritur, kemi marrë rezultate të rëndësishme, kemi grumbulluar 18 pikë, edhe pse kishim skuadra si Andorra dhe San Marino. Është e qartë që janë ekipe të një niveli tjetër, por kemi mundur Hungarinë pastaj me Poloninë kemi bërë paraqitje të mirë pavarësisht prej rezultateve. Shpresojmë që ne të përsëritim rezultatet e tilla sepse ajo që dua të them është se Shqipëria është rritur dhe mund të përballemi me kokën lart me



çdo kundërshtar, përfshirë këtu edhe Anglinë, Francën edhe Gjermaninë, por me ekipe të tjera ne kemi treguar se ne jemi të aftë që të luajmë si të barabartë", ka thënë Reja. "Duhet të shohim perspektivën, për të ardhmen, jo vetëm unë, por edhe FSHF-ja. Duhet të shihet nga Evropiani dhe të synojmë që të arrihet në finalen e Evropianit siç ka bërë dhe De

Biasi. Kjo do të ishte diçka fantastike për ne nëse do ta arrinim. Ekipi e ka treguar që është kompetitiv dhe në këtë pikëpamje duhet të falënderojmë të gjithë djemtë për atë që kanë bërë. Kanë dhënë maksimumin dhe ata janë përgjigjur në mënyrë të shkëlqyer dhe dua që t'i komplimentoj djemtë", ka shtuar Reja.

Lakersat zhgënjejnë, 'fluturojnë' Chicago dhe Miami

LOS ANXHELOS, 16 NËNTOR - Washingtoni, Chicago e Brooklyni janë në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes në NBA. Një fitore të rëndësishme korri Washingtoni, që mundi me rezultat 105-100 New Orleansin, ndeshje ku u dallua Dinwiddie me 27 pikë. Jashtë fushës fiton ekipi i Chicago Bullsit, që mposhti



lakersat me rezultat 121-103. Takim i dominuar nga miqtë, ku u dallua DeRozan me 38 pikë, mbështetur edhe nga Balli me 27 pikë e LaVine me 26 pikë. Skuadra e Dallasit, falë 29 pikëve e 11 reboundeve të

Porzingis, fitoi me rezultat 111-101 ndaj Denverit, ndërsa Miami triumfoi 103-90 në shtëpinë e Oklahomas (Herro 26 pikë). Triumfon pa probleme edhe Bostoni, që mundi 98-92 Clevelandin (Tatum 23 pikë).

REZULTATET

Cleveland - Boston	92-98
Detroit - Sacramento	107-129
Washington - New Orleans	105-100
Atlanta - Orlando	129-111
New York - Indiana	92-84
Dallas - Denver	111-101
Memphis - Houston	136-102
Minnesota - Phoenix	96-99
Oklahoma - Miami	90-103
Portland - Toronto	118-113
Lakers - Chicago	103-121

SHKURT

Zvicra ia vazhdon kontratën trajnerit Murat Yakin

Federata e Futbollit e Zvicrës ia ka zgjatur kontratën trajnerit Murat Yakin pas suksesit që e arriti, duke u kualifikuar në Kampionatin Botëror që mbahet vitin e ardhshëm në Katar. Erdhi me skepticizëm në ekipin kombëtar të Zvicrës, pas suksesit historik që Petkovic e arriti në Evropian, por Murat Yakin e dëshmoi se e meriton pozitën e përzgjedhësit duke e dërguar Xherdan Shaqirin e Granit Xhakën me shokë në Kupën e Botës "Katar 2022". Me këtë kualifikim, kontrata e Yakin u zgjat automatikisht deri në vitin 2024, pasi arriti që ta siguronte kualifikimin në Botëror, duke lënë në "play-off" kampionin aktual të Evropës, Italinë.

Trajneri Yakin, në konferencën për media, pas fitores dhe kualifikimit mbrëmë, e konfirmoi lajmin. Murat Yakin ka përqindje më të mirë se trajnerët, paraardhësit e tij me 2.14 pikë për ndeshje.

Mançini: Shpresoj se do ta fitojmë Kupën e Botës

Kombëtarja e Italisë nuk ka arritur të kualifikohet direkt në Kampionatin Botëror "Qatar 2022". Skuadra përfaqësuese që drejtohet nga trajneri Roberto Mançini në ndeshjen e fundit ndaj Irlandës Veriore ka barazuar me rezultat 0-0. Italia mbetet e dyta në grupin C me 16 pikë, dy më pak se Zvicra që kualifikohet direkt në Botëror. Mançini ka thënë se Italia do të kualifikohet përmes "play-off"-it dhe shpreson që ta fitojë Kupën e Botës. "Tani përgatitemi për mars dhe kalojmë në 'play-off' të sigurt. Ne do ta rezervojmë vendin tonë në Kupën e Botës në mars dhe shpresojmë të fitojmë edhe turneun", ka thënë Mançini.

Bagnaia: Unë do të jem pasardhësi i Rossit në MotoGP

Piloti i ri italian Francesco Bagnaia, fitues i garës së fundit të këtij sezoni në MotoGP me Ducati, e mbylli renditjen përfundimtare në vendin e dytë. I ardhur nga akademia VR46, piloti 24-vjeçar shpreson që vitin tjetër të shpallet kampion bote, duke qenë edhe pasuesi i mësuesit të tij, legjendës Valentino Rossi. "Kjo fitore e fundit e këtij sezoni është për Rossi. Ai është një legjendë dhe e falënderoj që pati besim tek unë në fillimet e karrierës sime. Unë shpresoj t'ia shpërblej me një titull në MotoGP. Për mua do të ishte një ndër ta pasoja aventurën e tij dhe shpresoj të jem pasardhësi i tij", ka thënë Bagnaia. Për Bagnaian, ky ishte sezoni i tretë në MotoGP, i pari me Ducati zyrtar, ku korri katër fitore. Gjithsesi, motori italian u shpall kampion për konstruktorë. "Uroj që vitin tjetër të festojmë si Ducati ashtu edhe unë", tha Bagnaia, që në kategoritë më të ulët ka garuar me Racing Team VR46, ekipi i Valentino Rossi, me të cilin u shpall kampion bote në Moto2.

Shqipëria mbylli kualifikueset e Botërorit, Rama: Faleminderit për emocionet që na dhuruat!

TIRANË, 16 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë e ka mbyllur me fitore minimale ndaj Andorrës në "Air Albania" rrugëtimin për Botërorin Katar 2022. Pa dyshim që ky ishte një nga

edicionet më të mira të "kuqezinjve" pasi kurrë më parë nuk ia arritën të grumbullonin 18 pikë dhe të përfundojmë në vendin e tretë pas Anglisë dhe Polonisë. Në rrjetin social

"Facebook" ka reaguar kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili ka falënderuar futbollistët dhe trajnerin për emocionet e bukura që dhuruan. "Kombëtarja kuqezi nuk është e jona vetëm kur

fiton, por edhe kur humbet dhe ky i kësaj radhe mbetet një edicion i bukur i kuqezinjve, për të cilin të gjithë djemtë e kësaj skuadre dhe trajneri ynë meritojnë falënderime për emocionet

që na dhuruan e respekt për të 18 pikët që grumbulluan. Me grupin plot të rinj dhe përvojën e fituar në këto eliminatore, më e mira është ende përpara për këtë kombëtare", ka shkruar Rama.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti për Burime Njerëzore



Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë:27/10/2021 me nr ref: 01/0847, Policia e Kosovës:

VAZHDON AFATIN E KONKURSIT

Të publikuar nga data 28.10.2021 deri me datë 16.11.2021

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Policor

Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për dhjetë (10) ditë duke filluar nga data

17 Nëntor 2021 deri me datë **26 Nëntor 2021**.

Vëmendje: Kriteret në konkurs mbeten të njëjta si dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

Kandidatët të cilët kanë bërë gabim gjatë aplikimit apo bashkëngjitjes së dokumenteve kanë të drejtën që të adresojnë kërkesë në email adresën info@kosovopolic.com lidhur me problemin e tyre.

Sqarim: Kandidatët të cilët kanë vështirësi për aplikim online (ju mungojnë pajisjet për aplikim si dhe nuk kanë qasje në internet) mund të drejtohen në stacionin policor më të afërt për të bërë aplikimin online.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Pajisu me PEF/SF dhe lësho Kuponë Fiskal!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor aty ku nuk kërkohet të lëshohet faturë tatimore, janë të obliguar që të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale (PEF), gjegjësisht Sistem Fiskal dhe të lëshojnë Kuponë Fiskal.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen te tatimpaguesit, të cilët:

- Kërkohe të fiskalizohen, por nuk janë të pajisur me PEF/SF;
- Janë të pajisur me PEF/SF, por nuk lëshojnë Kuponë Fiskal;
- Lëshojnë kuponë jo-fiskal dhe përdorin pajisje jo-fiskale.



Disa nga veprimtaritë, si: tregti, prodhim, shërbim, shëndetësi, hoteleri, arsim, transport, artistike-zbavitëse, etj. nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që të pajisen me PEF/SF dhe të lëshojnë Kuponë Fiskal.

ATK, inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë kërkesave ligjore, në të kundërtën do të aplikohen ndëshkimet administrative, ashtu siç janë përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenia shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Krijo mirëqenie të përgjithshme, merr Kuponin Fiskal!

Administrata Tatimore e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Uprava za Ljudske Resurse



Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o Radnom Odnosu Br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakona o Polnoj Ravnopravnosti br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o Zaštiti od Diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativno Uputstvo 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III član 8, i 9 tačka 1 i 2, i Odluke Generalnog Direktora od 27/10/2021 pod br. ref: 01/0847, Policia Kosova:

PRODUŽAV ROK KONKURSA

Objavljenog od dana 28.10.2021 do dana 16.11.2021

Naziv radnog mesta: Policijski službenik

Rok za podnošenje aplikacija produžava se za deset (10) dana počev od **17 Novembra 2021** do **26 Novembra 2021**.

Pažnja: Uslovi na konkursu ostaju isti i kandidati koji su konkurisali na ovom konkursu ne moraju ponovo da konkurisu.

Kandidati koji su pogrešili tokom konkurisanja ili dostavljanja dokumentacije imaju pravo da podnesu zahteve na email adresu info@kosovopolic.com u vezi njihovih problema.

Objašnjenje: Kandidati koji imaju poteškoće da se prijave putem interneta (nedostaje oprema za prijavu i nemaju pristup internetu) mogu da se obrate u najbližu policijsku stanicu da se prijave putem interneta.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Belle Massage” Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Belle Massage” Prishtinë, donelo odluku o prestani ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Belle Massage” Prishtinë, has come to the decision to quit company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.1688 datë 16.11.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), UA nr.05/2015 (Normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2021/2022

1.SHFMU "Destan Bajraktari" në Suharekë

- Një mësimdhënës/e për mësim klasor(zëvendësim i pushimit të lehonisë)
- Një edukatore për paralelen parashkollore

2.SHFMU "Besim Ndrecaj" –Maçitevë

- Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe (zëvendësim i pushimit të lehonisë).

3.SHFMU "Kongresi i Manastirit" në Studençan

- Një mësimdhënës/e për lëndën e edukatës fizike (zëvendësim i pushimit të lehonisë).

4.SHFMU " Lidhja e Prizrenit " në Budakovë

- Dy mësimdhënës/e për mësim klasor në paralelen e ndarë në Budakova II (zëvendësim të pushimit të lehonisë)

5.SHFMU " Shkëndija"-Suharekë

- Një edukatore për paralelen parashkollore në paralelen në Reçan

6.SHMP"Abdyl Ramaj"-Shirokë

- Një mësimdhënës/e për lëndën e TIK-ut (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
- Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe (zëvendësim i pushimit të lehonisë)

7.Gjimnazi"Jeta e re"-Suharekë

- Një mësimdhënës/e për lëndën e matematikës (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
- Një mësimdhënës/e për lëndën e psikologjisë (zëvendësim i pushimit të lehonisë)

Kushtet: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.05/2015 dhe UA-MASHT- nr.05/2021.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës ,duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit,Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit public.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br.1688 od 16.11.2021 godine

U skladu sa Zakonom o javnim službenicima br. 06 / L-114,Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068,Al br.05/2021(Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), AU br.05 / 2015 (Normativa za nastavnike stručnog obrazovanja),Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru.Opština direkcija za obrazovanje objavljuj i novo obavljuje:

KONKURS

Za popunu slobodnih mesta za školsku godinu 2021/2022

1.OSNŠ" Destan Bajraktari"-Suva reka

- Jedan nastavnik/ca za razredu nastavu (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- Jedan nastavnik/ca za predškolskog obrazovanje

2. OSNŠ" Besim Ndrecaj"-Maçiteve

- Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika(zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

3. OSNŠ" Kongresi i Manastirit"-Studenčan

- Jedan nastavnik/ca za predmet fizička vaspitanje (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

4. OSNŠ" Lidhja e Prizrenit"- në Budakovë

- Dve nastavnik/ca za razredu nastavu u Budakovo II (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

5. OSNŠ" Škendija"- Suva reka

- Jedan nastavnik/ca za predškolskog obrazovanje u odelenje u Reçane(zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

6. SHMP"Abdyl Ramaj"-Široko

- Jedan nastavnik za predmet TIK (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- Jedan nastavnik za predmet albanskog jezika(zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

7.Gimnazi"Jeta e re"-Suva reka

- Jedan nastavnik za predmet matematike(zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)
- Jedan nastavnik za predmet psihologije (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

Uslovi:Za ova slobodna radna mesta obavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021 i AU MONT- 05/2015 .

Dokumentacija potrebna za konkurs:

- Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
- Ekstrakt rođenja

-Lična karta (fotokopija)

-Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)

-Dokaz da nije pod istragom

-Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju(ako ga ima)

- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a

Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano,dok će se originalni dokumenti podstavljavati u intervju.

Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.

Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelarija u Opštine Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15(petnaest)dana od obavljenu u novinama

Orasporedu intervju bićete obavešteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.

Direktor prosvete
Remzi Bajselmani




>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► N.T.SH. " Blendi Metal" Flamur Gabrica B.I. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. 811075812, nrb. 70924595 si dhe nr. fis. 600921359.

► "Exclusive Globex Group" SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. 810872912

► Ymer Xhimshiti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "28 Nëntori " Brodosanë.

► Elmira Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI- IX SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.

► Qlirim Tertini shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Byrhan Bajmak shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi " Prizren.

► Shasivar Palla shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:000272

Datë: 08.11.2021

Numri i dokumentit: 02373214

C.nr.606/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, me bashkëpunëtorin profesional Armond Omega, në çështjen juridike të paditësit Arton Morina nga fshati Ratkoc – Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Sefer Morina nga Prizreni, kundër të paditurës Yvonne Suzanne Rochat Ademaj nga Zvicra, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkursorëzim, me datë 08.11.2021, merr këtë:

AKTVENDIM

I. FTOHET paditësi Arton Morina nga fshati Ratkoc – Komuna e Rahovecit, që në afat prej 7 ditësh të bëjë **PËRKTHIMIN E AKTVENDIMIT C.nr.606/20 të datës 08.11.2021, nga gjuha shqipe - në gjuhën angleze dhe publikimin e tij në njërin nga gazetat e përditshme në Republikën e Kosovës.**

II.Nëse këtë nuk e bënë brenda afatit prej 7 ditësh, do të konsiderohet se propozimi për çaktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në këtë çështje është tërhequr, në kuptim të nenit 102.3 të LPK-së.

Arsyetim

Paditësi Arton Morina nga fshati Ratkoc – Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Sefer Morina nga Prizreni, ka parashtruar padi kundër të paditurës Yvonne Suzanne Rochat Ademaj nga Zvicra, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.606/20 të datës 08.11.2021 ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Myhedin Beker, avokat nga Rahoveci, i cili aktvendim duhet të publikohet në Gazetën Zyrtare të Rep. së Kosovës, dhe për ta publikuar në Gazetën Zyrtare, nevojitet që aktvendimi i lartëcekur të përkthehet në gjuhën angleze, pasi që është detyrim që në Gazetën Zyrtare vendimet të publikohen në gjuhën angleze.

Meqenëse për të vepruar në këtë çështje kontestimore, nevojitet përkthimi i aktvendimit të lartëcekur, publikimi i tij në njërin nga gazetat e përditshme në Rep. e Kosovës, e që në rast



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

